



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Eksperti Shqyrtues	Data e pranimit të ekspertit	Date e dorëzimit të raportit	Nr. i lëndës
Burim Guri	26.01.2026	03.02.2026	2026/0035

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 16.01.2026, OE “MBB Construction SH.P.K.”- Prishtinë, ka parashtruar ankesë me nr: 2026/0035, kundër anulimit të aktivitetit të prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Punimi i rrethojës, renovimi i fasades dhe veshja e shkalleve të hyrjes” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-9681-5-2-1", të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure të hapur, lloji i kontrates: pune, vlera e parashikuar e kontrates: 63,235.00 €.

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04 / L - 042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04 / L - 237, Ligjin 05 / L - 068, dhe Ligjin 05 / L - 092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP-së

Neni 7 i LPP-së

Neni 52 i LPP-së

Neni 59 i LPP-së

Neni 60 i LPP-së

Neni 62 i LPP-së

Neni 40 i Rregullores Nr.001/2022 Për Prokurim Publik

Neni 43 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Autoriteti kontraktues me dt.29.12.2025 ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK-së, ku përsëri e ka anuluar aktivitetin e prokurimit, më arsyetimin se asnjë ofertë nuk është e përgjegjshme, ndërsa neve na ka eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Duke bazuar në nenin 62. Pika 1.1 të LPP një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.
Komisioni i vlerësimit konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar tetë (8) oferta. Komisioni i vlerësimit ka vërejtur se gjatë fazës së përpilimit të listës së përshkrimit të çmimeve tek **Pozicioni B-FURNIZIMI DHE PUNIMI/SANIMI I FASADES NE DR MITROVICË VERI** ka ndodhur një gabim teknik pasi që vendi ku duhet të kryhen Punimet është **DRP.Mitrovicë-Jugu**.

Duke u bazuar në nenin 44.3 të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK Sipas Paragrafit 3 i nenit 44 i RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmojnë Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde andaj komisioni i vlerësimit ka kërkuar të anulohet aktiviteti i prokurimit për arsye të lartë cekura

Arsyetimi i autoritetit kontraktues është i paqëndrueshëm, i pa bazuar dhe në tërësi në kundërshtim me dispozitat ligjore të LPP-së. Sa për sqarim, neve gjatë vlerësimit na janë kërkuar sqarime shtesë nga ana e AK-së, tri herë radhazi.

Fillimisht me dt.04.12.2025 na është dërguar letra standarde për njoftim të llogaritjes së gabuar, më pastaj me dt.18.12.2025 na është dërguar letra standarde e kërkesës për informata mbi tenderët jo-normalisht të ulët. Gjithashtu edhe me dt.24.12.2025 na është dërguar letër standarde për sqarim të tenderit, ku AK-ja ka kërkuar që të rritim vlerën e ekzekutimit në 30% të vlerës së kontratës. Tani pas të gjitha sqarimeve të cilat i përmendëm më lartë autoriteti kontraktues pasi që e ka vërejtur që ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe njëkohësisht kemi pranuar të rritim vlerën e sigurimit të ekzekutimit, autoriteti kontraktues e anulon aktivitetin e prokurimit me një arsyetim absurd.

Autoriteti kontraktues që nga fillimi e ka parë titullin e pozicionit B të paramasës, prandaj këtë arsyetim të anulimit e shohim si tendencioz me qëllim që ne të mos rekomandohemi për kontratë. Përderisa janë paraparë të gjitha pozicionet dhe punët të cilat do të kryhen në këtë

aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat janë në përputhje me planin e autoritetit kontraktues, atëherë fjala “veri” tek titulli i pozicionit të lartcekur nuk mund dhe nuk duhet të merret si arsye e bazuar për anulim të aktivitetit, pasi që ky aktivitet i prokurimit mund të përfundohet në tërësi sipas paramasës, pa marrë parasysh emrin e pozicionit. E rëndësishme është se nuk ka asnjë gabim në paramasë i cili do të ndikonte në realizim të kontratës, prandaj përderisa nuk ka një gabim të tillë të pariparueshëm atëherë ky projekt mund të zhvillohet dhe përfundohet pa asnjë problem. Arsyeja e anulimit eventualisht mund të quhet një lëshim teknik e asgjë më shumë.

Përderisa të gjitha hapat e kësaj procedure kanë kaluar dhe tani ka mbetur vetëm që të shpallet OE i rekomanduar për kontratë, atëherë është absurde të anulohet aktiviteti i prokurimit me një arsyetim të tillë. Nëse eventualisht një gjë e tillë do të konsiderohej gabim në momentin që është publikuar aktiviteti, atëherë AK-ja do ta kishte anuluar aktivitetin e prokurimit pa kërkuar sqarime fare apo edhe para hapjes së tenderëve, mirëpo ky veprim i AK-së është veprim diskriminues ndaj nesh me qëllim të mos rekomandohemi për kontratë. Anulimi i kësaj procedure të prokurimit është bërë në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së.

Në nenin 43.5 të Rregullores 001/2022 Për Prokurimin Publik, janë të përcaktuara saktë arsyet se kur mund të anulohet një procedurë pas dorëzimit të ofertave. Arsyet e përcaktuara në dispozitën e lartcekur janë si më poshtë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;

b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm; RREGULLORE Nr.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK 81

c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3(tre);

d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë, në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata, që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/ konkurruese me negociata është më pak se 3; f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;

g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;

h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;

i. një shkelle e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;

j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes se procedures ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm; ose

k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.

Kur analizohen arsyet e specifikuara në dispozitën e lartcekur, shihet qartë se asnjëra nga këto arsye nuk është plotësuar për të anuluar aktivitetin e prokurimit, prandaj edhe arsyetimi i autoritetit kontraktues është i pa bazuar dhe njëkohësisht i pa mbështetur në ndonjë dispozitë ligjore.

Andaj kërkojmë nga ana e AK-së që pasi të analizoj pretendimet tona ankimore, të aprovoj kërkesën tonë dhe të bëj vlerësimin e ofertave konform dispozitave ligjore dhe pastaj të nxjerr një vendim meritore në lidhje me ofertën tonë.

Duke u bazuar në të gjitha të lartcekurat, kuptohet qartë se ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit, prandaj edhe është dashur të rekomandohemi për kontratë dhe jo të anulohet aktiviteti i prokurimit me arsye të tilla të paqëndrueshme.

Ne me dt.09.01.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, me arsyetimin se e njëjta është e pa bazuar, mirëpo autoriteti kontraktues në asnjë mënyrë nuk ka mundur të dëshmojë me fakte konkrete refuzimin e kërkesës tonë, por ka dhënë arsye të krejtësisht të pa bazuara.

Autoriteti kontraktues në vendimin e saj është arsyetuar si në vijim:

AK Policia e Kosoves nuk ka anuluar aktivitetin e prokurimit per munges te ofertave te pergjegjshme AK e ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi eshte bere gabim ne specifika ne dosjen e tenderit po ashtu edhe ne piken 5.1 te FTD ku thuhet vendini i realizimit te punimeve eshte Mitrovicë Veriu po ashtu edhe ne seksionin B te specifikave teknike shkruar ne paramas Mitrovica e Veriut, AK kur ka themeluar komision per hartim te specifikave teknike ne vendim shkruar se duhet te behen speifikat per SP Mitrovica e Jugut por ka rrjedhur gabimi.

Ne lidhje me ket leshim kemi edhe konfirm nga njesia kekruse qe kerkon anulimin e ketije aktivitei te prokurimit per gabimin qe ka rrjedhur dhe kerkojne anulim te aktivitetit per ti korigjuar specifikat teknike dhe per ti rishikuar ne teresi ket kerkes Drejtoria e Prokurimit e ka pranaur me daten 29.12.2025 dhe Drejtoria e prokurimit menjeher ka bere anulimin pas gabimit te leshaur.

Mangesit ne paramasë jane shfaqur pase hapjes se tenderit andaj ju njoftojmë se titulli i përshkrimit dhe vendi i realizimit te punëve është dashur të jetë DRP. Mitrovicë-Jugu, andaj aktiviteti të anulohet dhe rregullohet përshkrimi, vendimi i realizimit dhe rishikim i specifikave.

AK nuk ka anuluar aktivitetin e prokurimit për asnjë arsyeje tjetër por vetëm për ato qe u than me lart, ne lidhje me ofertën tuaj janë kërkuar sqarime mirëpo ky leshim ne dosjen e tenderit dhe specifikat teknike është vërejtur pas atyre sqarimeve.

Arsyetimi i autoritetit kontraktues për refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i paqëndrueshëm, sepse ashtu siç e kemi cekur edhe më lartë përderisa janë paraparë të gjitha pozicionet dhe punët të cilat do të kryhen në këtë aktivitet të prokurimit dhe të njëjtat janë në përputhje me planin e autoritetit kontraktues, atëherë fjala “veri” tek titulli i pozicionit të lartcekur nuk mund dhe nuk duhet të merret si arsye e bazuar për anulim të aktivitetit, pasi që ky aktivitet i prokurimit mund të përfundohet në tërësi sipas paramasës, pa marrë parasysh

emrin e pozicionit. Pra e rëndësishme është se nuk ka asnjë gabim në paramasë i cili do të ndikonte në realizim të kontratës, prandaj përderisa nuk ka një gabim të tillë të pariparueshëm atëherë ky projekt mund të zhvillohet dhe përfundohet pa asnjë problem. Arsyeja e anulimit eventualisht mund të quhet një lëshim teknik e asgjë më shumë, mirëpo në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të jetë cilësohet arsye e bazuar për të anuluar aktivitetin e prokurimit, prandaj edhe arsyetimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar dhe i pa mbështetur në dispozita ligjore.

Autoriteti kontraktues ka dhënë vetëm një arsyetim sipërfaqësor, pa sqaruar se si konkretisht emërtimi i pozicionit do të pengonte realizimin e kontratës apo do të krijonte paqartësi për operatorët ekonomikë. Prandaj këtë veprim të autoritetit kontraktues ne e shohim vetëm si justifikim për të mos na rekomanduar për kontratë neve si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë në këtë aktivitet të prokurimit.

Autoriteti kontraktues ka theksuar se lëshimi në dosjen e tenderit dhe në specifikacionet teknike është vërejtur vetëm pas kërkesave për sqarime. Megjithatë, një arsyetim i tillë nuk qëndron, pasi nga rrethanat faktike (sqarimet që na janë kërkuar) kuptohet se autoriteti kontraktues paraprakisht ka analizuar dokumentacionin e tenderit, paramasën dhe ofertën tonë, dhe ka konstatuar se oferta i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, duke qenë njëkohësisht oferta me çmimin më të lirë.

Kjo vërtetohet edhe me faktin se autoriteti kontraktues, pas përfundimit të fazës së sqarimeve në lidhje me ofertën tonë, na ka kërkuar edhe rritjen e sigurimit të ekzekutimit të kontratës, kërkesë të cilën ne e kemi pranuar. Një veprim i tillë tregon qartë se procedura ndodhet në fazën përfundimtare dhe se kanë mbetur vetëm veprimet formale drejt shpalljes së fituesit. Megjithatë, pavarësisht se të gjitha procedurat janë zhvilluar dhe nuk është identifikuar asnjë mangësi që do të ndikonte në realizimin e kontratës, autoriteti kontraktues ka vendosur anulimin e aktivitetit të prokurimit, duke u mbështetur në një arsyetim të paqëndrueshëm. Nëse do të ekzistonte ndonjë gabim thelbësor që do të cenonte përmbushjen e kontratës siç pretendon AK-ja, atëherë e njëjta do ta kishte identifikuar dhe adresuar këtë çështje në fazat e hershme të procedurës, pasi që siç e k vërejtur tani këtë tekst të njëjtën do ta kishte vërejtur edhe gjatë hartimit të dosjes së tenderit dhe paramasës.

Prandaj kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura dhe njëkohësisht pasi është vërtetuar saktë se nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e përcaktuara në nenin 43.5 të Rregullores 001/2022 Për Prokurimin Publik, se kur mund të anulohet një procedurë pas dorëzimit të ofertave, atëherë kuptohet qartë se vendimi i AK-së për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është i pa bazuar.

Duke u bazuar në faktet që u ceken më lartë konstatojmë se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në harmoni me nenin 59 të LPP-së, sepse ne jemi eliminuar edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë. Kur kemi pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë edhe në kundërshtim me nenin 43.5 dhe 43.7 të Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e

kësaj dispozite, ndërsa ju sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, ku edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FTD-së dhe të njoftimit për kontratë nuk jemi rekomanduar për kontratë. Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente”, mirëpo AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore.

Po ashtu nuk është respektuar edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

I. APROVOHET, e bazuar ankesa e OE MBB Construction SH.P.K.

II. ANULOHET, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-s.

KRITERET PËR VLERËSIM

Pranueshmëria e Operatorëve Ekonomik	6.4	Kërkesat e përshtatshmërisë: <i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a) Deklarata nën betim se operatori ekonomik përmbushë kërkesat mbi përshtatshmërinë neni 65 të Ligjit nr. 04 L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04 L-237, ligjin Nr. 05 L-068 dhe ligjin. No. 05 L-092, do të dorëzohen në formë të Aneksit 2. b) Një vërtetim nga Administrata Tatimore e vendit tuaj të themelimit, se ju nuk jeni me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore-Departamenti për Çështje Ekonomike- Një dokument të lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush “Kërkesat e përshtatshmerise” së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës d) Vërtetim nga një Gjykatë kompetente ku vërteton se drejtuesit, menaxheret e saj gjatë dhjetë viteve të kaluara nuk janë shpallur fajtor nga një gjykatë kompetente për kryerjen e një veprë penale ose civile duke përfshirë praktikën e korrupsionit, larjen e parave, dhënien e mitos, avantazhe ose aktivitetet e ngjashme Dokumentet (nën b, c dhe d) duhet të dorëzohen nga tenderuesi fitues, para publikimit të dhënies së kontratës. Dështimi për të paraqitur një nga këto dokumente brenda afatit kohor, do të thotë që tenderuesi do të refuzohet dhe Autoritetit Kontraktues do të vazhdojë tenderuesin e listuar në vendin e dytë. a) Një deklaratë e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. b) Vërtetim nga Administrata Tatimore c) Vërtetimin nga Gjykata Themelore - Departamenti për Çështje Ekonomike – origjinal d) Vërtetimin nga Gjykata Themelore – origjinal
---	------------	--

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale	7.1 & 7.2	Përshtatshmëria profesionale: a) Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit. b) Certifikata e TVSH-se (për Operatoret Ekonomik vendor)	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> a) Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit) b) Certifikatën e TVSH-së (kopje) (për Operatoret Ekonomik vendor)
Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare	8.1 & 8.2	Kapaciteti ekonomik dhe financiar: Kërkesa 1: Operatori ekonomik duhet të ofrojë dëshmi të kënaqshme AK-së, se qarkullimi vjetor i Operatorit Ekonomik, gjatë tre viteve të fundit ka qenë në vlerë, se bashku në të tri vitet, prej jo më pak se 65,000.00 €.	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i> Dëshmia 1. OE duhet të dëshmojë me deklaratat Tatimore Vjetore të dorëzuara në Administratën Tatimore të Kosovës apo në vendin e themelimit për tri vitet e fundit.
Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale	9.1 & 9.2	Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare</i>

		Kërkesa 1 - Lista e stafit profesional të operatorit ekonomik me përbërje si ne vijim: • Një (1) Inxhinier i diplomuar i Ndërtimtarisë-Drejtimi Konstruktiv (master apo bachelor) me minimum përvojë pune 3 vite pas diplomimit. • Një (1) Inxhinier i diplomuar i Arkitekturës me minimum 3 vite përvojë pune pas diplomimit.	Dëshmi 1 - Lista e stafit profesional duhet të jetë e nënshkruar dhe e vulosur nga OE dhe dëshmitë për secilin inxhinierë si ne vijim • Kontrata ose para kontrata e punës valide me punëdhënësin, • Diploma e inxhinierëve përkatës sipas lëmis së kërkuar , • CV-it- e inxhinierëve, • Referencat mbi përvojën e punës (në referenca duhet të jen të saktësuara vitet e punës nga secili punëdhënësi)
		Kërkesa 2 - OE duhet ta ofrojë listën mbi mjetet e punës e nënshkruar dhe vulosur nga OE me pajisjet ne vijim: Një kamioni qe ka te inkorporuar vinçin në të dhe pesha bartëse te vinçit te jetë min. 3 T (pesha është për aftësim mbartës te vinçit) ose (vetëm) vinç , Skele në m², gjithsej 950 m² minimum.	Dëshmia 5- Listën e pajisjeve e nënshkruar dhe vulosur nga OE. Të gjitha makineritë të cilat i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për automjete, duhet të jenë të regjistruara dhe me afat të regjistrimit dëshmi librezë e regjistrimit valide . Në rast se pajisjet janë në pronësi të OE apo te marruara me qera duhet dëshmuar pronësi e këtyre pajisjeve, DUD Doganor ose faturë për pajisjet te cilat nuk i nënshtrohen LIGJI Nr. 05 L-132 ligji për regjistrim te automjete, gjithashtu te dëshmohen me foto. Në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet të ofroj marrëveshjen për marrjen me qira të pajisjeve. Marrëveshja duhet të jetë në emër të këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga të dyja palët si dhe duhet dëshmuar pronësi e këtyre pajisjeve, DUD Doganor ose faturë.

			Për peshën ngritëse të vinçit duhet të dëshmohet me <u>tiket të vendosur në vinç ose me homologim valid.</u>
		Kërkesa 3- Lista prej minimum 16 punëtorëve që drejtpërdrejtë janë përgjegjës për kryerjen e punëve përkatëse për këtë projekt. • Minimum Një (1) person të certifikuar për saldum.	Dëshmia 3 -Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi Listën e punëtorëve të kompanisë me të dhënat në vijim Kontrata ose para kontrata e punës <u>valide me punëdhënësin, Emri , mbiemrin dhe pozicioni në kompani, e nënshkruar dhe i vulosur nga OE si dhe kopjen e certifikatës për saldus.</u>

RAPORTI I KOMISIONI VLERËSUES

DEKLARATË

Duke bazuar në nenin 62. Pika 1.1 të LPP një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodhë në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

Komisioni i vlerësimit konstaton se për këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar tetë (8) oferta. Komisioni i vlerësimit ka vërejtur se gjatë fazës së përpilimit të listës së përshkrimit të çmimeve tek **Pozicioni B-FURNIZIMI DHE PUNIMI/SANIMI I FSADES NE DR MITROVICË VERI** ka ndodhur një gabim teknik pasi që vendi ku duhet të kryhen Punimet është DRP.Mitrovicë-Jugu.

Duke u bazuar në nenin 44.3 të RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK

Sipas Paragrafit 3 i nenit 44 i RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK neni 44.3 Qëllimi i dokumenteve standarde është që të ndihmohen Operatorët ekonomik gjatë përgatitjes së ofertave. Deklaratat duhet të përmbajnë kërkesat minimale të përcaktuara në formularët standard pa ndryshime në përmbajtje, pa prezantimin e kufizimeve apo kushteve shtesë, ose pa fshirjen e ndonjë kushti të përcaktuar nga autoriteti kontraktues në format standarde. Por kompania që bën deklaratën ka të drejtë që të vendos logon, emrin e kompanisë apo grafikë në krye të faqes „header” apo kudo tjetër në dokumentet standarde andaj komisioni i vlerësimit ka kërkuar të anulohet aktiviteti i prokurimit për arsyet e lartë cekura

INFORMACIONET SHITESË TË MARRA ME ANË TË SQARIME TË KËRKUARA NGA EKSPERTI SHQYRTUES/TEKNIK

--

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP

--

VENDIMET E MËPARSHME TË OSHP LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

--

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES - **MBB Construction SH.P.K.**

Sqarim hyres; Autoriteti Kontraktues – POLICIA E KOSOVËS, ka zhvilluar aktivitetin e prokurimit me titull: “Punimi i rrethojës, renovimi i fasadës dhe veshja e shkallëve të hyrjes”, me numër të prokurimit: 214/30400-25-9681-5-2-1, Procedura e procedurë e hapur, ndërsa lloji i kontratës është pune.

Me date **16.01.2026**, “**MBB Construction**” **SH.P.K.**, me seli në Prizren, ka paraqitur **ankese pranë Organit Shqyrtues te Prokurimit**, duke kundërshtuar Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues kunder anulimit të dates 29.12.2025, si ne vijim:

Eksperti shqyrtues sqaron se pas shqyrtimit të vendimit të Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosoves per anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe analizës se ankesës se Operatorit Ekonomik “**MBB Construction**” **SH.P.K.**, vleresohet se anulimi i procedures eshte kryer ne kundërshtim me dispozitat e Ligjit per Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022.

Autoriteti Kontraktues e ka arsyetuar anulimin kryesisht me pretendimin se në dosjen e tenderit është përcaktuar gabimisht vendi i ekzekutimit te punimeve si “**Lluzhan, Mitrovicë Veriu, Kamenicë**”, nderkohe qe punimet sipas tij është dashur të realizohen ne Mitrovicë të Jugut. Megjithatë, kjo pasaktesi buron nga dokumentacioni i hartuar vetë nga AK-ja dhe përbën përgjegjesi ekskluzive të saj, ndersa operatorët ekonomikë nuk mund të penalizohen për gabime administrative mbi te cilat nuk kane pasur asnje ndikim.

Ne kete kontekst, theksohet se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar kriteret strikte per anulim te procedures sipas nenit 43.5 të Rregullores Nr. 001/2022, i cili percakton shprehimisht:

“Në nenin 43.5 të Rregullores 001/2022 për Prokurimin Publik, janë të përcaktuara saktë arsyet se kur mund të anulohet një procedurë pas dorëzimit të ofertave. Arsyet e përcaktuara në këtë dispozitë janë si më poshtë:

43.5 Procedura e prokurimit pas hapjes së ofertave duhet të anulohet për një nga arsyet e mëposhtme:

- a. asnjë tender nuk është paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- b. asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm;*
- c. numri i OE të përgjegjshëm për kontratë publike kornizë me më shumë se një OE është më pak se 3 (tre);*
- d. nuk ka kërkesa për të marrë pjesë në procedurat e kufizuara ose konkurruese me negociata që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- e. numri i kandidatëve të kualifikuar në procedurën e kufizuar/konkurruese me negociata është më pak se 3;*
- f. nuk ka projekte që janë paraqitur brenda afatit të specifikuar;*
- g. asnjë nga projektet e pranuar në konkursin e projektimit nuk janë të përgjegjshëm;*
- h. nëse urdhërohet nga Organi Shqyrtues i Prokurimit;*

i. një shkelje e ligjit ka ndodhur ose do të ndodhë dhe nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një ndryshimi;
j. nëse AK gjatë përgatitjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim, me verifikim të KRPP-së, është i pariparueshëm; ose
k. nëse është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar dhe jashtë kontrollit të AK-së dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP.”

Eksperti shqyrtues sqaron nga dokumentacioni i procedurës rezulton se OE ankues ka kaluar te gjitha fazat e vleresimit, ka dhene sqarimet e kërkuara nga AK-ja, ka pranuar rritjen e sigurimit te ekzekutimit dhe ka përmbushur te gjitha kerkesat e dosjes së tenderit, çka deshmon se oferta e tij eshte konsideruar e pergjegjshme dhe procedura ka qene në fazen perfundimtare drejt rekomandimit per kontratë.

Nje pasaktesi në emertimin e lokacionit, e cila nuk ndikon ne permbajtjen teknike te projektit dhe nuk perben gabim thelbësor apo te pariparueshëm, nuk perben baze ligjore per anulim as sipas nenit 62 të LPP-se dhe as sipas nenit 43.5 të Rregullores Nr. 001/2022. Perkundrazi, kjo situatë është dashur të adresohet permes sqarimit ose korrigjimit administrativ nga vetë AK-ja, pa qene e nevojshme anulimi i procedurës.

Në kete kontekst, anulimi bie ndesh edhe me nenin 59 të LPP-se, pasi oferta e OE ankues është eliminuar ndonese ka permbushur te gjitha kerkesat e dosjes së tenderit, si dhe me nenin 7 të LPP-se qe garanton trajtim te barabarte, mosdiskriminim dhe transparence.

Andaj, eksperti shqyrtues vlereson se ankesa e OE “MBB Construction” SH.P.K. është e bazuar, ndersa vendimi i Autoritetit Kontraktues per anulimin e aktivitetit të prokurimit është i kunderligjshem dhe i pambeshtetur ne dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik dhe Rregullores Nr. 001/2022. Per rrjedhoje, rekomandohet anulimi i vendimit te AK-se dhe kthimi i lendes n rivleresim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE “**MBB Construction SH.P.K.**”, lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Punimi i rrethojës, renovimi i fasadës dhe veshja e shkallëve të hyrjes**” me numër të prokurimit: “**214/30400-25-9681-5-2-1**”, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **POLICIA E KOSOVËS**

Raporti i ekspertizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **POLICIA E KOSOVËS**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP**
- OE ankues – **MBB Construction SH.P.K.**

Burim Guri

